



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 23.01.2020

Dokument parlamentar

(Komision përgjegjës)

R A P O R T

PËR AKTIT NORMATIV NR.10 DATË 18.12.2019 “PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR.8438, DATË 28.12.1998 “PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT”, TË NDRYSHUAR

I. Hyrje

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 23.01.2020, mori në shqyrtim Akti normative nr. 10 datë 18.12.2019 “Për disa shtesa në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, bazuar në nenet 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Për shqyrtimin e këtij projektligji u caktua relator Znj. Evis Kushi.

Për të prezantuar aktin normativ në emër të Qeverisë, ishin të pranishëm Z. Pandeli Majko Ministri i Shtetit për Diasporën, Z. Elton Xhaxhi Zv. Ministër i Financave dhe Ekonomisë si dhe përfaqësues të tjerë të kësaj ministrie.

II. Baza ligjore Kushtetuese

Akti normativ është propozuar nga Këshilli i Ministrave në përputhje me nenin 101 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Akti normativ shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68, të Rregullores së Kuvendit.

III. Qëllimi dhe përmbajtja e aktit normative.

Qëllimi

Qëllimi i këtij akti normativ është shtimi në listën e përjashtimeve nga tatimi mbi të ardhurat, edhe të të ardhurave nga pensionet dhe shpërblimet e tjera të ngjashme të shtetasve të huaj me origjinë shqiptare apo të atyre nga vendet e Bashkimit Evropian, me leje qëndrimi në Republikën e Shqipërisë si dhe të shtetasve të huaj që kanë marrë shtetësinë shqiptare e janë rezidentë në Republikën e Shqipërisë dhe që i përfitojnë këto të ardhura sipas legjislacionit të vendit ku përfitojnë pensionin apo shpërblimet e tjera të ngjashme.

Përmbajtja e aktit normativ

Akti normativ përbëhet nga 3 nene gjithsej.

- Në nenin 1, të aktit, propozohet shtimi i pikës 1/1 në nenin 8/1, të ligjit, duke shtuar si përjashtim të ardhurat nga pensionet dhe shpërblimet e tjera të ngjashme të shtetasve të huaj me origjinë shqiptare apo të atyre nga vendet e Bashkimit Evropian, me leje qëndrimi në Republikën e Shqipërisë, si dhe të shtetasve të huaj që kanë marrë shtetësinë shqiptare e janë rezidentë në Republikën e Shqipërisë dhe që i përfitojnë këto të ardhura sipas legjislacionit të vendit ku përfitojnë pensionin apo shpërblimet e tjera të ngjashme.
- Në nenin 2, të aktit, parashikohet se pas nenit 8/1, të ligjit, shtohet neni 8/2, i cili parashikon kushtet e përfitimit nga përjashtimi nga tatimi mbi të ardhurat, me këtë përmbajtje, garantohet trajtimi i njëjtë, parashikohet e drejtat e ankimit administrativ si dhe strukturat përgjegjëse zbatuese direkt.
- Neni 3 i aktit, është hyrja në fuqi e aktit.

IV. Efektet financiare

Ky akt normativ nuk ka efekte financiare shitesë në buxhetin e shtetit.

V. Shqyrtimi i projektligjit në komision.

Relatori i Komisionit, në fjalën e tij u shpreh se akti normativ i propozuar nga Këshilli i Ministrave shtohen lehtësitë për shtetasit e huaj dhe shtetasit e huaj me origjinë shqiptare për të zgjedhur Shqipërinë si vendbanimin e tyre pas daljes në pension.

Për ta bërë të zbatueshëm këtë përjashtim, akti normativ ka përcaktuar edhe kushtet që duhet të plotësojë një shtetas për ta përfituar atë. Këto kushte konsistojnë në:

- a) Shtetasit e huaj (me origjinë shqiptare apo nga BE) duhet të jenë përfitues të pensionit sipas legjislacionit në fuqi në vendet ku e kanë përfituar atë dhe të jenë të pajisur me leje qëndrimi në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- b) Këta shtetas nuk duhet të kenë qenë ndonjëherë të dënuar në shtetin e vet apo në Republikën e Shqipërisë ose në ndonjë shtet tjetër për vepra penale, për të cilat ligji parashikon dënime me jo më pak se 3 vjet heqje lirie; si dhe
- c) Të kenë marrë përgjigje pozitive nga struktura përgjegjëse administrative për përjashtim nga tatimi mbi të ardhurat personale të përfitimit të pensionit.

Mënyra e përfitimit për kategoritë përfituese do të përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Akti normativ, garanton trajtim të barabartë të subjekteve përfituese, të drejtën për ankimim administrativ si dhe ka përcaktuar organet tatimore si strukturë përgjegjëse për zbatimin e këtij akti. Përmes zbatimit të këtyre lehtësive pritet një impakt pozitiv në rritjen e lëvizjes së shtetasve të huaj në drejtim të Shqipërisë, forcimin e lidhjeve të shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë me vendin e origjinës, rritjen e kërkesës për shërbime në nivel vendor, zhvillim të ofertës për shërbime, kujdes e turizëm.

Pavarësisht sa më sipër, relatori i komisionit, evidentoi edhe disa shqetësime që konsistojnë:

- Në nevojën për tu sqaruar nga propozuesi të “nevojës” dhe “urgjencës” që ka ekzistuar në momentin e daljes së këtij akti normativ.
- Nëse akti normativ është konsultuar me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë si dhe të evidentimit të arsyeve se përse ky akt normativ nuk është propozuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë e cila administron ligjin për tatimin mbi të ardhurat si dhe harton politikat fiskale të shtetit.

Ministri i Shtetit për Diasporën, sqaroi se akti normativ është miratuar më 18.12.2019, që është edhe dita e diasporës në Shqipëri dhe njëkohësisht edhe në BE.

Vendi ynë kaloi momente shumë të vështira në nëntor të vitit 2019, duke krijuar kështu një emergjencë fatkeqësie natyrore, emergjencë e cila vijon edhe sot. Gjatë gjithë kësaj kohe, emigrantët Shqiptarë kanë dhënë një ndihmesë të jashtëzakonshme e cila duhet të vijojë të stimulohet përmes një politike “agresive” edhe nga politikat fiskale, duke mundësuar kështu, bërjen e vendit tonë më atraktiv dhe forcimin e lidhjeve me vendin e origjinës.

Përfaqësuesi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, sqaroi se akti normativ është konsultuar me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave dhe se kjo e fundit ka shprehur dakortësinë e saj lidhur me aktin. Gjithashtu ai u shpreh se akti nuk ka impakt fiskal dhe se Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka mbështetur dhe do të vijojë të mbështesë në vijimësi diasporën dhe politikat stimuluese e lehtësuese që lidhen me të.

VI. *Përfundime*

Në përfundim të shqyrtimit, Komisioni për Ekonominë dhe Financat vlerësoi se miratimi i këtij akti normativ, do të ketë impakt pozitiv në rritjen e lëvizjes së shtetasve të huaj në drejtim të Shqipërisë dhe forcimin e lidhjeve të shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë me vendin e origjinës dhe me votat pro të të gjithë anëtarëve të pranishëm, e miratoi aktin normativ nr. 10 datë 18.12.2019 “Për disa shtesa në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar.

RELATOR

Evis KUSHI

KRYETAR

Milva EKONOMI